



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

Nr. 4/04/7
Prot

Tiranë, më 10/07/2018

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 93, Datë 10/07/2018

“PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR”

Në përputhje me ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2019-2021

- Tavanet Përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, të miratuara nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore do të merren në konsiderate për hartimin e buxhetit të vitit 2019.
- Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore do të mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, si dhe në ligjin nr.68/2017 datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Transferta specifike për vitin 2019, do të jetë në të njëjtin nivel financimi si transferata specifike e vitit 2018.
- Formula, kriteret dhe koeficientet e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2019 do jenë ato të vitit 2018.
- Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës specifike për vitet 2019-2021, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2018. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/specifike do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse të saj.
- Kuadri ekonomik 2019-2021, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të

burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.

- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të PBA-së.

II. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
- Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.
- Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor.

III. Instrumenti i Planifikimit Financiar për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, i rishikuar

Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, për fazën e dytë do të përgatitet nëpërmjet:

- Instrumentit të Planifikimit Financiar të Programit Buxhetor Afatmesëm, të rishikuar.
- Relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm 2019-2021), të rishikuar.

IV. Mbështetja Këshillimore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2019-2021, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore adresat e e-mailit: Fran.Brahimi@financa.gov.al, Elidona.Durmishi@financa.gov.al.

MINISTËR

Arben Ahmetaj